



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Nr. ____ Prot

Tiranë, më __. __. 2019

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data: 13.11.2019]

Për: **“ALKED KOPAÇI” PF**

Rruga e " Kavajes", Pallati nr 102, Shkalla nr 1, K,Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e hapur”- Mallra** - Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me objekt: **“Blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbime profilaktike për Komandën Mbështetëse”** ndarë në dy lote, me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër: **72,823,320** (shtatëdhjetë e dy milion e tetëqind e njëzet e tre mijë e treqind e njëzetë) **Lekë pa TVSH**, me numër reference të procedurës kryesore: **REF-21327-05-09-2019**

Numri i referencës së **Lotit II: REF-21332-05-09-2019**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Lotit II “Blerje bateri për automjete”**, me fond limit të marrëveshjes kuadër **22,543,765** (njëzet e dy milion e pesëqind e dyzet e tre mijë e shtatëqind gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, dhe me shumatore të çmimeve për njësi **355,370.83** (treqind e pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë pikë tetëdhjetë e tre) pa TVSH dhe me afat kohor për ekzekutimin:

- Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave me përfundim deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, brenda afatit **24**-(njëzet e katër) muaj te lidhjes se kontratës Marrëveshjes Kuadër.

Publikime të mëparshme (jo): Buletini i Njoftimeve Publike 13.05.2019, Nr: 19.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1) **“ALSTEZO” SHA**

J63208420N

- | | |
|--|-------------------------------|
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |
| Vlera (shumatorja e çmimeve për njësi): 217,700 (dy qind e shtatëmbëdhjetë mijë e shtatë qind) lekë (pa TVSH) <i>(me numra dhe fjalë)</i> | |
| 2) “ALKED KOPAÇI” PF | K41510041C |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |
| Vlera (shumatorja e çmimeve për njësi): 218,600 (dy qind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtë qind) lekë (pa TVSH) <i>(me numra dhe fjalë)</i> | |
| 3) “KADIU” SHA | J61817045K |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |
| Vlera (shumatorja e çmimeve për njësi): 241,417 (dy qind e dyzet e një mijë e katër qind e shtatëmbëdhjetë) lekë (pa TVSH) <i>(me numra dhe fjalë)</i> | |
| 4) “KAPPA-OIL” SHA | J91402501L |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |
| Vlera (shumatorja e çmimeve për njësi): 229,400 (dy qind e njëzet e nëntë mijë e katër qind) lekë (pa TVSH) <i>(me numra dhe fjalë)</i> . | |

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:

➤ **Arsyet e skualifikimit të ofertuesit “KAPPA - OIL” SHA**

- Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 7 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të shtojcën 9 të DT-së, pasi nuk arriti të paraqesë katalogë/ broshurë të baterive, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Të gjithë dokumentat e hedhura, si pjesë të ofertës dhe të emërtuara “HEAVY DUTTY SHQIP”, “Nato bateri shqip 2019”, “Passenger cars shqip 2019 marked” nuk janë të lëshura nga kompanitë prodhuese, të deklaruara ne tabelën e përgjithshme të ofertës teknike. Po ashtu, ky dokumentacion nuk është i përkthyer nga përkthyes zyrtarë dhe nuk është i vërtetuar me origjinalin nga noteri publik.*

➤ **Arsyet e skualifikimit të ofertuesit “KADIU” SHA**

Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 7 të seksionit 2.3 “Kapaciteti teknik” të shtojcën 9 të DT-së, pasi nuk arriti të paraqesë katalogë/ broshurë të baterive, ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara. Dokumenti i hedhur, si pjesë të ofertës dhe i emërtuar “KATALOG FAAM Bateri përkthim & noterizim” nuk rezulton të ketë të përkthyer në gjuhën shqipe specifikimet teknike të kërkuara në shtojcën 10 (specifikimet teknike) të DT-së.

➤ **Arsyet e skualifikimit të ofertuesit ALSTEZO” SHA**

Në zbatim të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr. 1645/2 prot., datë 30.09.2019 ku janë konstatuar:

Në disa nga bateritë e ofruara ka mospërputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në

shtojcën nr 10 “Specifikimet teknike”, në dokumentet standarte të tenderit. Gjithashtu, për disa nga bateritë, ofertuesi ka ofruar për dy lloje kapacitetesh (AH) të kërkuar në dokumentet e tenderit, një lloj baterie, pra vetëm një nga kapacitetet (AH) të kërkuara në specifikimet teknike, më konkretisht:

Për baterinë me nr rendor 1, me kapacitet 55 (AH), në katalogët teknik dhe në listën e baterive që shoqërojnë katalogët teknik të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi ka ofertuar bateri me kapacitet 56 (AH).

Për baterinë me nr rendor 3, me kapacitet (65 AH), në katalogët teknik dhe në listën e baterive që shoqërojnë katalogët teknik të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi ka ofertuar bateri të njëjtë me baterinë që i korrespondon nr rendor 4, me kapacitet (66 AH).

Për baterinë me nr rendor 5, me kapacitet 75 (AH), në katalogët teknik dhe në listën e baterive që shoqërojnë katalogët teknik të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi ka ofertuar bateri me kapacitet 80 (AH).

Për baterinë me nr rendor 7, me kapacitet 88 (AH), në katalogët teknik dhe në listën e baterive që shoqërojnë katalogët teknik të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi ka ofertuar bateri me kapacitet 90 (AH).

Për baterinë me nr rendor 10, me kapacitet 105 (AH), në katalogët teknik dhe në listën e baterive që shoqërojnë katalogët teknik të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi ka ofertuar bateri të njëjtë me baterinë që i korrespondon nr rendor 11, me kapacitet 110 (AH).

Për baterinë me nr rendor 13, me kapacitet 120 (AH), në katalogët teknik dhe në listën e baterive që shoqërojnë katalogët teknik të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi ka ofertuar bateri të njëjtë me baterinë që i korrespondon nr rendor 14, me kapacitet 125(AH).

Gjithashtu për artikujt (bateritë) më nr rendor 16 me kapacitet 135(AH) dhe me nr rendor 17 me kapacitet 165 (AH), në katalogët teknik dhe në listën e baterive që shoqërojnë katalogët teknik të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga ofertuesi “Alstezo” SHA konstatohen mospërputhje më specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet standarte të tenderit dhe specifikimet teknike të ofruar nga ana e ofertuesit. Më konkretisht për artikullin më nr rendor 16, kapaciteti i ofruar nga ofertuesi është 143 (AH), për artikullit nr 17 kemi mospërputhje si në kapacitet ashtu dhe në vendosjen e poleve. Në specifikimet tekniketë dokumentave të tenderit ky artikull është kërkuar më kapacitet 165 (AH) dhe vendosje te poleve 0 (zero) ndërsa ofertuesi e ka ofertuar atë me kapacitet 170 (AH) dhe në vendosje të poleve 3 (tre).

Për baterinë me nr rendor 18, me vendosje të poleve 0(zero), në katalogët teknik dhe në listën e baterive që shoqërojnë katalogët teknik të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi ka ofertuar bateri me vendosje të poleve 3(tre).

Për baterinë me nr rendor 19, kapacitet 185 (AH), në katalogët teknik dhe në listën e baterive që shoqërojnë katalogët teknik të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi ka ofertuar bateri të njëjtë me baterinë që i korrespondon nr rendor 20, me kapacitet 200 (AH). Gjithashtu për këto bateri vendosja e poleve nuk është 0 (zero) siç është kërkuar në shtojcën 10 specifikimet teknike të dokumentave te tenderit, por është 3 (tre).

Lidhur me kapacitetin e kërkuar të baterive, sqarojmë se diferenca në (AH) ndërmjet ofertës dhe kërkesës sjell anomali në sistemit elektrik/ të ndezjes së motorrit, pasi në rast se një mjeti përkatës i vendoset një bateri me kapacitet më të lartë sesa ajo e projektuar nga konstuktori, sjell çrregullim në sistemin elektrik të mjetit gjatë ndezjes fillestare të tij. Gjithashtu gjeneratori nuk

arrin asnjëherë të karikoj baterinë në kapacitetin e saj të plotë gjë që sjell ndër të tjera edhe “lodhjen” para kohe të baterisë.

Lidhur me vendosjen e poleve ndërmjet asaj çfarë kërkohet dhe çfarë është ofertuar sqarojmë se mospërshatja e poleve sipas skicave respektive e bën jo funksionale vendosjen e baterive në mjetet e përcaktuara. Projektuesi e ka shprehur qartë në manualin teknik të mjeteve lidhur me të dhënat teknike të nevojshme për secilin mjet si: tensionin e nevojshëm, amperazhin e nevojshëm, kapacitetin e nevojshëm, përmasat fizike në milimetër, vensosja e poleve, etj. çdo lloj modifikimi apo përshtatje tjetër lidhur me këtë pikë bën që mjeti të mos punojë në gjendjen e tij optimale, gjë që sjell pasiguri në operimin e sistemit elektrik/të ndezjes.

Në këto katalogë figurojnë vetëm dy nga tre llojet e baterive të llojit NATO të kërkuara në dokumentet e tenderit. Me konkretisht në shtojcën 10 “Specifikimet teknike” në dokumentet e tenderit janë kërkuar lloji i baterisë 100NA, 110NA dhe 125NA. Ofertuesi ka ofertuar për baterinë me nr rendor 9 dhe baterinë me nr rendor 12 në katalogët teknik dhe në listën e baterive që shoqërojnë katalogun teknik vetëm një artikull, me një part-number prodhuesi për të dy llojet e baterive të këkuar. Pra për baterinë e tipit 100 NA ofertuesi ka ofertuar baterin 110 NA, e cila ka specifikime teknike të ndryshme nga ato të kërkuara për llojin e baterisë 100 NA në Shtojcën 10 “Specifikimet teknike”. Gjithashtu nga katalogjet për bateritë NATO pesha e këtyre artikujve është e ndryshme nga specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 10 në dokumentet e tenderit, më konkretisht:

Për 125 NA në DT është kërkuar pesha 34,5 kg ndërsa artikulli i ofruar nga ofertuesi ka peshën 30,5 kg.

Për 110 NA në DT është kërkuar pesha 32,5 kg ndërsa nga ofertuesi është ofruar artikulli me peshë 28,7 kg.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1) “ALKED KOPAÇI” PF

K41510041C

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera (shumatorja e çmimeve për njësi): **218,600** (dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë)

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë organit qendror blerës Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr.3, Tiranë, Tel: 042247865, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19.06.2019

Njoftimi i Ri-Klasifikimit është bërë: 11.07.2019; 18.07.2019; 02.10.2019

Ankesa: Po;

Ka marrë përgjigje nga Organi Qendror Blerës në datë 01.07.2019; 02.07.2019; 15.07.2019; 30.09.2019

Kanë marrë përgjigje nga KPP në datë 03.09.2019;

**TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**